



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E MALISHEVES
THE MUNICIPALITY OF MALISHEVE



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E MALISHEVES

14/04/2021
PRILBENO:

Nr. Mo. Br. 08/242



Thirrje publike për ekspertë të jashtëm për Komisionin Vlerësues për Projektpropozime të OJQ-ve aplikuese në Thirrjen publike nr. prot.01/215, dt.07.04.2021

Komuna e Malishevës, gjatë vitit 2021, përmes Thirrjes Publike nr. 01/215, planifikon të ofrojë mbështetje financiare për OJQ-të kulturore, rinore dhe sportive, konkretisht mbështetjen e projekteve dhe programeve kulturore, rinore dhe sportive.

Rregullorja MF-Nr-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, në Nenin 8, paragrafin 3.2 parasheh që pjesë e Komisionit Vlerësues për vlerësimin e projektpropozimeve të OJQ-ve aplikuese në thirrjen publike

Thirrja Publike është për dy (2) anëtarë, prej tyre- një përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm dhe një përfaqësues nga OJQ.

Komuna e Malishevës i fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë në thirrjen publike për ekspertë të jashtëm, për të qenë pjesë e komisionit vlerësues për projektpropozimet e dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes Thirrjes Publike nr.01/215.

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët që janë:

- shtetas të Republikës së Kosovës
- të punësuarit apo anëtarët aktiv në OJQ që janë aktive në Republikën e Kosovës;
- ekspertë të pavarur, që kanë përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projekteve apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- duhet të kenë diploma universitare
- të paktën 1 vit përvojë pune;
- të kenë përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projekteve
- të mos jenë të emëruar politikë;
- të mos jenë shërbyes civil;
- të mos jenë punëtorë të Administratës Shtetërore;

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- një CV
- një letërmotivimi
- dëshmi për shkollimin;
- dëshmi për përvojën e punës

- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër delegimi nga përfaqësuesi i autorizuar i OJQ-së në të cilën aplikuesi është anëtar apo i punësuar.

Detyrat e Komisionit Vlerësues

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues janë të përcaktuara me rregullore, e që janë:

- të vlerësojë aplikacionet nga aspekti procedural sipas rregullores;
- të vendos nëse aplikantët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të parapara me rregullore për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike;
- të shqyrtojë dhe vlerësojë aplikacionet/propozimet e aplikantëve të kualifikuar për mbështetje financiare nga aspekti përmbajtësor;
- të sigurojë që projektet/programet e përzgjedhura për mbështetje financiare i plotësojnë të gjitha kriteret e thirrjes publike, dhe i kontribuojnë arritjes së prioriteteve dhe objektivave të thirrjes;
- të kërkoj dokumentacion shtesë të nevojshëm nga aplikuesit pas publikimit të listës paraprake të përfituesve dhe para nënshkrimit të kontratës;
- të përzgjedh përfituesit e mbështetjes financiare sipas thirrjes publike.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: dkrs_malisheva@hotmail.com, deri më 27.04.2021 dhe me anë të kopjes fizike, në Zyrën për pritjen e palëve në objektin e komunës.

Komuna e Malishevës, pasi të bëjë vlerësimin e aplikacioneve të kandidatëve, do të formojë regjistrin e ekspertëve të jashtëm dhe të njoftohen të gjithë kandidatët e përzgjedhur.